



Pranimi / Primese / Received	24-02-2022	2	viti / god / year
Organ / Organizma / Org. Unit	SIKPM/SHIK	983/2022	1/4
Titulli / Titulli / Title			
Shprehje / Shprehje / Appendix			
Sasia / Krahina / Quantity			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.61/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.61/2022 të datës 25.01.2022, të parashtruar nga ankuesit

të cilit me autorizim i përfaqëson si përfaqësuese e përbashkët, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.02.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.61/2022 e datës 25.01.2022, e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesit, të punësuar në Policinë e Kosovës-Drejtoria Rajonale në Ferizaj, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të përbashkët me datë 25.01.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim të shujtave ditore dhe pagës së trembëdhjetë (13) për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021 sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.01.2022 ka proceduar kërkesën për

përgjigje në ankesë të Policia e Kosovës. Ndërsa me datë 11.02.2022, Këshilli ka pranuar shkresat ndërlidhur me çështjen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 342/2022 të datës 25.01.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 11.01.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 679/2022 të datës 11.02.2022; e-mailin e datës 28.12.2021 të Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0831 të datës 11.09.2015, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0282 të datës 22.05.2014, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0306 të datës 22.05.2014, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0195 të datës 10.01.2014, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0835 të datës 11.09.2015, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0198 të datës 10.01.2014, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0829 të datës 11.09.2015, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/1001 të datës 11.09.2015, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0959 të datës 11.09.2015, Kontratën e punës me numër reference 0518 të datës 07.11.2011, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0324 të datës 11.09.2014, Kontratën e punës me numër reference 07/1-01A/0809 të datës 11.09.2015, Kontratën e punës me numër reference me numër 0479 të datës 10.10.2011, e mailin e datës 23.02.2021 të dërguar nga organi i punësimit lidhur me konfirmim e statusit të ankueseve sipas kërkesës së Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesve, *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesi sipas Kontratës së punës me numër reference 07/1-01A/0831 të datës 11.09.2015, është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Financa" Zyra për Administrim, Prokurorim dhe Financa/Drejtoria Rajonale Ferizaj, sipas Kontratës së punës me numër reference 07/1-01A/0282 të datës 22.05.2014, është i punësuar në pozitën e punës "Asistent Administrativ", Drejtoria Rajonale Ferizaj, ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër reference 07/1-01A/0306 të datës 22.05.2014, është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare e Personelit", Zyra për Administratë dhe Personel/Drejtoria Rajonale Ferizaj, ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër reference 07/1-01A/0195 të datës 10.01.2014, është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për bazën e të dhënave", Sektori i Operatives /Drejtoria Rajonale Ferizaj, ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër reference 07/1-01A/0835 të datës 11.09.2015 është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për bazën e të dhënave", Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugore/Drejtoria Rajonale Ferizaj, ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër reference 07/1-01A/0198 të datës 10.01.2014 është e punësuar në pozitën e punës "Asistente Administrative", Sektori Rajonal për Resurse /Drejtoria Rajonale Ferizaj, ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër reference 07/1-01A/0829 të datës 11.09.2015 është e punësuar në pozitën e punës " Zyrtare e Personelit", Zyra për Administratë dhe Personel/Drejtoria Rajonale Ferizaj, ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër reference 07/1-01A/1001 të datës 11.09.2015, është e punësuar në pozitën e punës "Asistente Administrative", Njësia Rajonale e Komunikimit Rrugor/ Drejtoria Rajonale Ferizaj, ankuesi sipas Kontratës e punës me numër reference 07/1-01A/0959 të datës 11.09.2015, është i punësuar në pozitën e punës "Mirëmbajtës i armeve", Sektori Rajonal për Resurse/Drejtoria Rajonale Ferizaj; ankuesi sipas Kontratës së Punës me numër



reference 0518 të datës 07.11.2011, është i punësuar në pozitën e punës “Teknik i Telekomunikimeve”, Drejtoria Rajonale Ferizaj; ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër reference 07/1-01A/0324 të datës 11.09.2014, është e punësuar në pozitën e punës “ Udhëheqës i Njësisë për Shërbime Mbështetëse”, Drejtoria Rajonale Ferizaj; ankuesi sipas Kontratës së Punës me numër reference 07/1-01A/0809 të datës 11.09.2015, është i punësuar në pozitën e punës “Teknik i Rrjetës”, Zyra e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit/Drejtoria Rajonale Ferizaj, dhe ankuesi sipas Kontratës së Punës me numër 0479 të datës 10.10.2011, është i punësuar në pozitën e punës “Teknik i Radiokomunikimit”, në Departamenti i Sigurisë Publike,/Drejtoria Rajonale Ferizaj.

Me tej, nga vlerësimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesit me datë 28.12.2021 kanë parashtruar ankesë me bazë të njëjtë ankimore në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, ndërsa ky i fundit po me datë 28.12.2021, përmes emailit ka njoftuar Shefin e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë Rajonale të Ferizajt, që Komisioni i Ankesave nuk ka kompetencë lëndore për çështjen në fjalë, duke udhëzuar që ankesa të parashtrohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Pas kësaj përgjigje, ankuesit brenda afatit ligjor parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i njuhë të drejtën e kompensimit të shujtës ditore dhe pagës së trembëdhjetë dhe mbi këtë bazë kanë kërkuar që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj organin e punësimit për kompensimin e shujtës ditore dhe pagës së trembëdhjetë për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, ashtu siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, stafi civil në Policinë e Kosovës, i është nënshtruar përveç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.

Andaj, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, përkatësisht nenin 47 të këtij ligji ku përcaktohet se: ... 2.Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe benificione..., 3.Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Benificionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe benificionet e pensionit; 4.Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesat, kompensimet dhe benificionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtarët policor, gjegjësisht vetëm për kategorinë e personelit policor të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, duke u thirrur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e



Kosovë, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marr parasysh konstatimin se ligji i veçantë nuk ka rregulluar çështjen e shtesave dhe kompensimeve tjera përtej pagës bazë për stafin civil të Policisë së Kosovës, vlerëson se për këtë kategori të të punësuarve në Policinë e Kosovës, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me datë 09.07.2020 ka nxjerr Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në pikën 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon funksionet dhe organizativet e Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, andaj, bazuar në këtë dhe duke i'u referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji konstaton se stafi civil në Policinë e Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara vetëm sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 61/2022

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të përbashkët të ankuesëve;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.